



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planimi / Doretuar Primitje / Prodato Received / Delivered	09.08.2022	viti god year	
Organ / Pjesa Organ / Jedinka Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shmimi Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRPIHCH	4610/2022		1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 616/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.616/2021, të datës 07.07.2021, të ankuesit

Komuna e Istogut, sipas Aktgjykimit A.Nr.2456/2021, të datës 22.06.2022, të Gjykatës Themelorë në Prishtinë/Departamenti për Çështja Administrative, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A. Nr. 616/2021, të datës 07.07.2021, të ankuesit

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 27.04.2021, ka nxjerr vendim A. Nr. 112/2021, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin e datës 09.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Shërbimi Korrektues i Kosovës, me qellim të zbatimit të Vendimit të Këshillit, me datë 08.06.2021, ka ndryshuar akt emërimin, me të cilin ka përcaktuar koeficientin shtatë (7).

Ankuesi _____ e datë 07.07.2021, me numër protokoli 3501/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e koeficientit shtatë (7), për përudhen nga data 09.02.2022, deri me datë 27.04.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.08.2021, me numër protokoli 4301/2021, ka njoftuar ankuesin _____ se nuk mundë të shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën A. Nr. 616/2021, të datës 07.07.2021, për shkak se Këshilli nuk ka mundësi të vendimmarrjes, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi _____ i pakënaqur me njoftimin e datës 23.08.2021 të Këshillit, ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 22.06.2022, A. Nr. 2456/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 23.08.2021, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 616/2021, të datës 07.07.2021, të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.616/2021 e datës 07.07.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimit A. Nr. 2456/2021, të datës 22.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi i datës 24.06.2022; Kërkesë për kompensim të pagës e datës 18.06.2021; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit i datës 08.06.2021; A. Nr. 112/2021, i datës 27.04.2021, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; lista e pagave e datës 01.06.2021, deri me datë 30.06.2021; Vendimi i datës 09.02.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt Emërimi i datës 06.03.2013; Përgjigje në ankesë e datës 21.07.2021, me numër protokoli 3830/2021;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit _____ është bërë i pamundur *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar Aktgjykimin e datës 22.06.2022, A. Nr. 2456/2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 23.08.2021, të Këshillit, me të cilin aktgjykim Këshillin e ka obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 616/2021, të datës 07.07.2021 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së Këshilli, ankuesit _____ me datë 27.04.2021, me vendim A. Nr. 112/2021, ka aprovuar ankesën e ankuesit

duke e lenë në fuqi Vendimin e datës 09.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të cilin Vendim ankuesit i ngritur koeficienti nga koeficienti gjashtë (6) në koeficient shtatë (7), andaj Kolegji konstaton se Shërbimit Korrektues të Kosovës me qëllimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.06.2021, ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit, është vendosur koeficienti shtatë (7), mirëpo sipas pretendimeve ankimore të ankuesit nuk e ka bërë kompensimin e pagës sipas Vendimit të datës 09.02.2021, me numër protokollit 0388, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, andaj Këshilli me qëllimin të vërtetimit të drejtët të gjendjes faktike, me datë 05.08.2022, ka dërguar e-mail me të cilin ka kërkuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, se a është bërë kompensimi sipas pretendimeve ankimore të ankuesit, ndërsa me datë 05.08.2022, me numër protokollit Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka dërguar dëshmi kërkesën për pagese retroaktivë sipas Vendimit të datës 09.02.2022, po ashtu i ka bashkangjitur edhe listën e pagave për muajin gushtë të vitit 2021, më të cilën dëshmohet së ankuesit ka realizuar kompensimi prej njëqind e pesëdhjetë e shtatë (157), ero andaj kolegji konstaton se pretendimi ankimore i ankuesit është përmbushur ne tersi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pa mundur sepse në bazë të dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*. Sepse në rastin konkret Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka bërë kompensimin e koeficientit sipas Vendimit të datës 09.02.2022, kolegji si provë për realizimin e kompensimin e ka analizuar kërkesën për pagese retroaktivë po ashtu i ka bashkangjitur edhe listën e pagave për muajin gushtë të vitit 2021, më të cilën dëshmohet së ankuesit ka realizuar kompensimi prej njëqind e pesëdhjetë e shtatë (157), ero he mbi bazën e kësaj Kolegji konstaton se pretendimi ankimore i ankuesit është bërë i pamundur dhe i kotë, prandaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vendosi si në diapozitiv të Vendimit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 616/2021

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Eshref SHABANI



Kryetari Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjyqtarit Ramush Bardiqi, Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Korrektues; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

